



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Vector Clean" Sh.P.K. të datës 04.05.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës -RITENDER" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Vector Clean" Sh.P.K. e datës 04.05.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës -RITENDER" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Vector Clean" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Vector Clean" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 04.05.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "34 Dezinsektimi hapësinor në Komunën e Prishtinës -RITENDER" me nr. të prokurimit 616-24-4214-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Në kërkesën për rishqyrtim parashtruesi ka deklaruar si vijon: *“Pas vendimit mbi anulimin e aktivitetit, AK ka bere shkelje duke vazhduar direkt me vendimin per anulim. Dy Operatore Ekonomik te pa kenaqur me vendimin e AK-se kan paraqitur Ankese ne OSHP. Duke i pare te gjitha keto, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar tutje me ritenderimin e ketij aktiviteti, ende pa pasur nje vendim nga OSHP”*.

Fillimisht duhet sqaruar se parashtruesi nuk ka arritur që të formuloj pretendime ankimore konkrete kundër njoftimit për kontratë apo dosjes së tenderit. Për më tepër as kërkesa për rishqyrtim nuk përmban të gjitha elementet që kërkohen përmes nenit 60 par. 3 pikat d), e), f) dhe h) të RRPP ku përcaktohet se:

“Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë:

- d.** *bashkëngjitur një kopje të njoftimit të kontratës në fjalë ose njoftimit të rezultatit të konkursit për projektim, nëse një e tillë është nxjerrë apo publikuar;*
- e.** *Demonstron se parashtruesi i ankesës kualifikohet si një “palë e interesuar,” sikurse përkufizohet nën nenin 4 të ligjit;*
- f.** *Përshkruan rrethanat faktike që përbejnë apo prodhojnë shkeljen e pretenduar;*
- h.** *Përshkruan se si është shkaktuar shkelja e pretenduar, apo kërcënon të shkaktojë, dëm material parashtruesit të ankesës në rastet ku parashtruesi i ankesës përfshin një padi për kompensim”*.

Sa i përket pikës d) të cituar, me kërkesën për rishqyrtim nuk është bashkëngjitur njoftimi për kontratë kundër të cilit është parashtruar.

Sa i përket pikës e) parashtruesi në asnjë formë nuk ka arritur që të demostroj se është palë e interesuar për kërkesën e tij për rishqyrtim. Në fakt deklarata e parashtruesi në kërkesë për rishqyrtim është e bazuar ekskluzivisht në faktin se (citim) *“Dy Operatore Ekonomik te pa kenaqur me vendimin e AK-se kan paraqitur Ankese ne OSHP. Duke i pare te gjitha keto, Autoriteti Kontraktues ka vazhduar tutje me ritenderimin e ketij aktiviteti, ende pa pasur nje vendim nga OSHP”*. Me fjalë të tjera kërkesa e parashtruesit bëhet në emër dhe llogari të operatorëve të tjerë ekonomik dhe jo në interesin e tij juridik të drejtpërdrejtë. Sipas nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP termi palë e interesuar është përcaktuar si vijon *“personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar”*. Në formën si është formuluar deklarata e parashtruesit është gjetur se i njëjti nuk ka dëshmuar asnjë interes material nga cilido rezultat i këtij aktiviteti të prokurimit. Eventualisht parashtruesi ka dëshmuar interesin material të operatorëve të tjerë ekonomik (për të cilët ka deklaruar se kanë parashtruar ankesë në OSHP) mirëpo jo edhe interesin e vet material të drejtpërdrejtë. Kësisoj është konfirmuar se parashtruesi nuk është fare palë e interesuar në kuptim të dispozitës së cituar si më sipër. Për më tepër parashtruesi ka kundërshtuar në tërësi faktin se është inicuar ky aktivitet i prokurimit.

Sa i përket pikës f) dhe h) është gjetur se parashtruesi nuk ka arritur që formuloj fare pretendime ankimore. Në fakt parashtruesi ka deklaruar se e kundërshton inicimin e këtij aktiviteti prokurimit mirëpo nuk ka arritur që të identifikoj se cila shkelje konkretisht ka ndodhur me këtë rast dhe aq më pak që të përshkruar rrethanat faktike që eventalisht do të kishin për të prodhuar këtë shkelje apo dëmin eventual që do të kishte për të pësuar parashtruesi me këtë rast.

Sa i përket pjesës së deklaratës ku parashtruesi aludon se ky aktivitet i prokurimit është tenderuar kundërligjshëm ndërsa aktiviteti i parë kinse është anuluar gabimisht, vlen të theksohet fakti se aktiviteti i parë është anuluar për shkak të një gabimi që ka ndodhur në dosjen e tenderit në kuptim të nenit 62 të LPP. Sa i përket anulimit të këtij aktiviteti për këtë arsye ligjore, autoriteti kontraktues para anulimit ka kërkuar opinion nga KRPP se si duhet vepruar në rastin përkatës. Rrjedhimisht anulimi është manifestuar vetëm pas udhëzimit të KRPP sipas të cilit anulimi është opsioni i vetëm teknik dhe juridik që ka autoriteti kontraktues në këtë rast. Me datë 15.04.2024 KRPP ka dërguar te autoriteti kontraktues konfirmimin se *“Arsyeja se pse OE nuk kane mundesi te plotesojne listen e cmimeve e cila eshte e publikuar ne proceduren 616-24-2103-2-1 eshte sepse lista e cmimeve nuk e ka te plotesuar pjesen/kolonen e sasive perkatese. Ky gabim nuk mund te korrigojohet ne kete faze te aktivitetit te prokurimit”*. Duke marrë parasysh faktin që autoriteti kontraktues është i detyruar që të respektoj me përpikmëri udhëzimet e KRPP, autoriteti kontraktues ka qenë i detyruar që të anuloj aktivitetin e prokurimit si të tillë dhe të njëjtin ta ritenderoj duke evituar shkaqet që kanë dërguar në anulimin e tij paraprak.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur deklaratimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.05.2024

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.